

VENDIM
Nr.4, datë 12.1.2000

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.129, DATË 18.3.1999 “PËR PROCEDURAT DHE PËR DHËNIEN E LEJEVE E TË AUTORIZIMEVE PËR TREGTIMIN E NAFTËS, GAZIT DHE NËNPRODUKTEVE TË TYRE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 21 të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin e tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.129, datë 18.3.1999, në kreun IV “Kushtet për pajisjen me leje tregtimi”, pika 7, ndryshohet si vijon:

“Kushti i kapacitetit minimal të depozitave, i vendosjes në to të mjeteve matëse e i kalibrimit të tyre, duhet të plotësohen nga subjektet që kryejnë aktualisht veprimtarinë sipas nenit 14 të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999, deri më datë 31.12.2000. Me plotësimin e këtyre kushteve jepet leja e tregtimit.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
ILIR META